



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
TIRANË


Rruga: “Aleksandër Moisiu”, Nr 80, Tiranë, Albania.
Tel: +355 4374756, Fax 355 43 70058

Tiranë, 7/10/ 2009

BULETINI EPIDEMIOLOGJIK MBI QARKULLIMIN E GRIPIT TE RI
PANDEMIK A(H1N1) NE SHQIPERI

Me poshte jepet nje pershkrim i gjendjes epidemiologjike dhe pasojave shendetesore lidhur me Gripin e ri pandemik A(H1N1) ne Shqiperi deri ne daten 6 Tetor 2009.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 20 - 39 të sezonit 2007 - 2008 dhe të sezonit 2008 – 2009. Numri i rasteve.
(përkatesisht deri me dt. 27. 09. 2009).



- Kemi nje rritje te numrit te infeksioneve respiratore krahasuar me nje vit me pare. Kete jave verejme nje trend ne rritje, te numrit te infeksioneve respiratore. Situata po ndiqet nga ana e ISHP-se
- Numri me i madh i rasteve te infeksioneve respiratore verehet ne moshat feminare.
- Nuk kemi shperthim epidemik te infeksioneve te ngjashme me Gripin. Numri javor i rasteve eshte shume i ulet krahasuar me pragun epidemik
- Deri ne daten 6 Tetor 2009, jane marre 840 mostra nga Tirana dhe rrethet. Numri me i madh i mostrave eshte marre ne grupmoshen 25 - 44 vjeç ku dhe vihet re dhe numri me i madh i rasteve te konfirmuara.
- Deri ne daten 6 Tetor 2009, jane konfirmuar **34** raste me virusin A(H1N1).
Te gjithë rastet tashme jane te sheruar.
- Çdo dite ne ISHP perpunohen mostra te rasteve te dyshuara nga Tirana dhe rrethet e tjera te vendit.